



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva.**

**DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL**

## **RAPORT I PUNËS** **(Janar- Qershor 2024)**

Në Komunën e Podujevës, Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural funksionin përmes një sektori:

### ➤ **Spektori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**

Në vazhdimësi punën në sektorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mund ta përmbledhim si në vijim:

Projektet e planifikuara dhe të realizuara për vitin 2024 - gjashtë mujori i parë

<b>Nr</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Vlera e Projektit</b>	<b>Faza e projektit</b>
<b>1</b>	<b>Subvencione per perimkulture</b>  - Përkrahja me serra bujqësore 50 m <sup>2</sup> dhe 500 m <sup>2</sup> .	357142	Projekt në proces  (faza e vlerësimit të aplikimeve)  Do të bëhet përkrahja e fermerëve me 35 serra 500 m <sup>2</sup> dhe 85 serra 50m <sup>2</sup> .

2	<b>Subvencione per blegtori</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkrahje me mëshqerra.</li> </ul>	385714	Projekt në proces (faza e vlerësimit të aplikimeve) Është planifikuar të përkrahen 154 fermerë me nga një mëshqerrë.
3	<b>Subvencione me mekanizëm bujqësor</b> Përkrahja e fermerëve me: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbjellëse pneumatike e misrit me plehrim 6 rendore;</li> <li>- Mbjellëse e misrit mekanike me plehrim;</li> <li>- Pllug rrotullues 4 rendor 12’;</li> <li>- Freza 1.8m;</li> <li>- Motokultivator me frezë;</li> <li>- Makinë për shtrirjen e folisë plastike, sistemit pikë-pikë dhe mbjelljen e fidaneve të perimeve;</li> <li>- Frezë për motokultivator 12HP.</li> </ul>	142857	Projekt në proces (Vazhdon të jetë e hapur thirrja për aplikim deri më 01.07.2024)
4	<b>Subvencion për pentari</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkrahje me fidane të feferonave;</li> <li>- Përkrahje me fidane të dredhëzës, sistem të ujitjes dhe foli;</li> <li>- Përkrahje me fidane të mjedrave.</li> </ul>	71428	Projekt në proces (faza e ekzekutimit të pagesave)
5	<b>Subvencione për bletari</b>	42257	Ende nuk është inicuar.

## **Projektet e realizuara në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë vitit 2024:**

DBPZHR bazuar në kriteret e MBPZHR-së është angazhuar në mbështetjen e fermerëve të komunës së Podujevës në përgatitjen e dokumentacionit të duhur për aplikimin e tyre në këto skema si dhe në përcjelljen e tyre në MBPZHR për shqyrtim dhe miratim. Ky aktivitet është zbatuar dhe është i ndarë sipas thirrjeve të MBPZHR-se për sektorët përkatës.

**THIRRJE PËR APLIKIM- Për Pagesa Direkte për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, therrjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri dhe akuakulturë për gjashtëmujorin e dytë 2024-** Në kuadër të kësaj thirrje nga MBPZHR nga data 15.01.2024 deri me datë 13.02.2024 ora 16:00 janë pranuar gjithsej 82 aplikacione të fermerëve të cilat janë proceduar për shqyrtim dhe miratim.

- **THIRRJE PËR APLIKIM- Për mbështetje përmes Programit për Pagesa Direkte për kulturat dhe aktivitetet bujqësore për vitin 2024-** Kjo thirrje nga MBPZHR ka qenë e hapur nga data 13.03.2024 deri me datë 29.04.2024 në ora 16:00, aplikacionet e fermerëve të cilat do të pranohen, do të dërgohen në procedurë për shqyrtim dhe miratim.

**Gjatë kësaj periudhe i gjithë stafi i DBPZHR ka punuar me kapacitet të plotë, duke përfshirë edhe punën jashtë orarit të rregullt të punës e poashtu edhe punën gjatë vikendeve.**

## **AKTIVITETE TË TJERA TË REALIZUARA**

- Kërkesa për regjistrimin me Numrin Identifikues të Fermerit (NIF);
- Kërkesa për shndërrimin apo ndërrimin e destinimit të tokave, me ç'rast gjatë kësaj periudhe janë lëshuar gjithsej 12 vendime për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
- Kërkesa për subvencione;
- Kërkesa të ndryshme.

## SEKTORI I PYLLTARISË

Sektori i Pylltarisë nga muaji Janar 2024, përmes memorandumit të bashkëpunimit mes Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe Komunës së Podujevës, kanë kaluar me Agjensionin Pyjor të Kosovës.

Podujevë

Nr. 12-101/04-0040833/24

Datë: 24.06.2024



**Drejtori DBPZHR**

**Dirie Hoti**